



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/181  
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Themelohet Këshilli për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile për vitet 2013-2017.
2. Këshilli është struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile.
3. Këshilli për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile për vitet 2013-2017 në përbërjen e tij ka 29 anëtarë, nga të cilët 14 janë përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 15 përfaqësues nga shoqëria civile.
4. Nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, 14 prej tyre përzgjidhen nga vet organizatat e shoqërisë civile ndërsa 1 emërohet nga Platforma CiviKos.
5. Këshilli udhëhiqet nga:
  - 5.1. z. Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit (Kryesues)
  - 5.2. z. Habit Hajredini, Drejtor në Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, zv. Kryesues
  - 5.3. Përfaqësuesi i emëruar nga Platforma CiviKos (Bashkëkryesues)
6. Përfaqësuesit tjerë të Qeverisë emërohen nga institucionet në vijim, të cilat përfaqësohen në nivel të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe drejtorëve përgjegjës:
  - 6.1. Ministria e Administratës Publike, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
  - 6.2. Ministria e Integritimit Evropian, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë

- 6.3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
  - 6.4. Ministria e Financave, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
  - 6.5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
  - 6.6. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
  - 6.7. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
  - 6.8. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtarë
  - 6.9. Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtarë
  - 6.10. Zyra për Planifikim Strategjik/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtarë
  - 6.11. Zyra për Komunikim me Publikun, Drejtori, një anëtarë
  - 6.12. Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Drejtori, një anëtarë
  - 6.13. Zyra Administrative/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtarë.
7. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit shërben si Sekretariat i Këshillit, dhe do të jetë në funksion për të zhvilluar dhe mirëmbajtur të gjitha aktivitetet e nevojshme për punën e Këshillit.
  8. Procesin e përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në Këshill do ta organizojë Platforma Civikos, në bashkëpunim me Sekretariatën e Këshillit, në bazë të një procedure demokratike, të hapur dhe transparente.
  9. Për mbarëvajtjen dhe për një punë të suksesshme të këtij Këshilli, Sekretariati do të mbështetet nga Zyra e Kryeministrit në aspektin financiar dhe me resurse njerëzore.
  10. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit mandatohet që në bashkëpunim me Platformën CiviKos të hartojë Termat e Referencës për punën e Këshillit, të cilat do të miratohen në takimin e parë të Këshillit.
  11. Obligohet Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi.
  12. Shfuqizohet vendimi i Qeverisë nr.02/167 i datës 22 janar 2014.
  13. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë